VENDIM
Nr.16, datë 19.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Sokol Berberi	Anëtar i " "
Admir Thanza	Anëtar i " "
Vitore Tusha	Anëtare e " "

me sekretare Blerina Çinari, në datë 4.06.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10/4 Akti që i përket:

KËRKUES: GËZIM HYSI, përfaqësuar nga av. Sokol Puto, me deklarim.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr.88, datë 21.02.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.970, datë 11.10.2005, ka deklaruar të pafajshëm shtetasin Gëzim Hysi për kryerjen e veprës penale të "mashtrimit", parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, dhe e ka deklaruar atë fajtor duke e dënuar me 200 000 lekë gjobë për kryerjen e veprës penale të "falsifikimit", parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.360, datë 21.04.2006, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përsa i përket deklarimit fajtor për kryerjen e veprës penale të "falsifikimit" dhe ndryshimin e këtij vendimi përsa i përket veprës penale të "mashtrimit", duke e dënuar kërkuesin përfundimisht me 6 muaj burgim.

Rekursin e kërkuesit, Kolegji seleksionues i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.akti 1175, datë 1.12.2006, e ka vlerësuar në përputhje me shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe e ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.9678, datë 13.01.2007 "Për dhënie amnistie", i cili hyri në fuqi para se të shqyrtohej çështja penale në seancë gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.88, datë 21.02.2007, vendosi pushimin e çështjes për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit "Për dhënie amnistie".

Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese pretendon se vendimi i Kolegjit

Penal të Gjykatës së Lartë nr.88, datë 21.02.2007, ka shkelur të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor duke argumentuar se:

- është cenuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, sepse Kolegji Penal duke zbatuar ligjin e amnistisë në çështjen objekt kundërshtimi i) nuk ka analizuar shkaqet e parashtruara në rekurs lidhur me pretendimet për pafajësinë ndaj akuzave penale të ngritura kundër tij, ndonëse kolegji seleksionues e kishte kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e vlerësuar në përputhje me kërkesat e nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale; ii) nuk është shprehur rreth bazueshmërisë ose jo në ligj të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.360, datë 21.04.2006, gjë që vjen në kundërshtim me nenet 441 dhe 442 të Kodit të Procedurës Penale;

- është cenuar e drejta e mbrojtjes, pasi procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në prani të prokurorit dhe në mungesë të mbrojtësit të të gjykuarit, ndonëse mbrojtësi ka paraqitur një raport mjekësor për pamundësi pjesëmarrjeje në seancën gjyqësore.

II

Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të çdo individi për një proces të rregullt ligjor. Në këtë vështrim, Gjykata mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit që, në parim, u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ, gjë që përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.06.2009*).

2. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka trajtuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo e drejtë e individit përbën garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 3.06.2009*).

3. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.07. 2006*).

4. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs me objekt prishjen e vendimit nr.360, datë 21.04.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendim që duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e deklaronte kërkuesin fajtor edhe për kryerjen e veprës penale të mashtrimit dhe, në bazë të nenit 143/1 të Kodit Penal, e dënonte atë me 6 muaj burgim.

Nga dosja gjyqësore rezulton se Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë, më datë 1.12.2006, ka vendosur kalimin e çështjes penale për shqyrtim në seancë gjyqësore duke

arsyetuar se rekursi i paraqitur nga i gjykuari përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 21.02.2007, në prani të prokurorit e të të gjykuarit dhe në mungesë të mbrojtësit të tij. Gjatë gjykimit, kryesuesi i seancës i ka dhënë fjalën prokurorit, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9678, datë 13.01.2007 "Për dhënie amnistie". Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ndodhet para rasteve të parashikuara nga neni 387/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe ka arsyetuar se nuk mund ta gjykojë çështjen (për shkaqet e ngritura në rekurs) dhe, për rrjedhojë, ka vendosur "Pushimin e çështjes në Gjykatën e Lartë".

5. Referuar konstatimeve të mësipërme dhe përmbajtjes së normave procedurale penale që përcaktojnë kufijtë dhe rregullat e shqyrtimit gjyqësor të rekursit të ushtruar kundër vendimeve të formës së prerë, Gjykata, vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar kërkesën paraprake të të gjykuarit për shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të mungesës së avokatit të tij; nuk është shprehur mbi shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi (rekursuesi), të cilat kanë të bëjnë me pretendimin e tij për pafajësi (nenet 432 dhe 434 të Kodit të Procedurës Penale); dhe nuk është shprehur për bazueshmërinë në ligj apo jo të vendimit të gjykatës së apelit, i cili ka qenë objekt i kundërshtimit të rekursit (nenet 441 dhe 442 të Kodit të Procedurës Penale).

6. Gjykata, në funksion të kontrollit të respektimit të standardit për akses në gjykim, vlerëson të shprehet paraprakisht për kuptimin kushtetues e ligjor të amnistisë, si dhe për pasojat që ajo sjell ndaj procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Amnistia, sipas nenit 81 pika 2 germa "ë" të Kushtetutës së Shqipërisë, miratohet me ligj nga Kuvendi me shumicën e tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij. Ajo përbën një masë të përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe, apo dënimeve përkatëse. Në trajtimin doktrinar penal dhe jurisprudencial të amnistisë njihen amnistia e veprës penale që vepron para dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit me pasojë shuarjen e veprës penale të kryer dhe amnistia e dënimit, e cila ndërhyn pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e dënimit, dhe të dënimeve aksesore edhe pse mbeten efektet e tjera penale. Ndryshimi midis tyre qëndron në faktin se amnistia e veprës penale sjell si pasojë mosfillimin ose pushimin e ndjekjes penale përpara se të jetë dhënë një vendim përfundimtar dënimi (i ekzekutueshëm), ndërsa amnistia e dënimit sjell efekte pas dhënies së vendimit të ekzekutueshëm.

Në nenin 71 të Kodit Penal përcaktohet se: "*Me aktin e amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë. Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe*". Nga përmbajtja e kësaj norme rezulton se akti i amnistisë parashikon disa organe të cilat, me hyrjen në fuqi të këtij akti (ligji për dhënie amnistie), marrin kompetencë për të përjashtuar nga ndjekja penale (*amnistia e veprës penale*), nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose për të bërë zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë (*amnistia e dënimit*). Kështu, Prokuroria, që në kuptim të nenit 148/1 të Kushtetutës është organi që ushtron ndjekjen penale dhe gjykata, që në kuptim të nenit 42 dhe 135 të Kushtetutës është organi kompetent që gjykon akuzat e ngritura ndaj individëve për vepra penale, me hyrjen në fuqi të ligjit për amnistinë, autorizohen të përjashtojnë nga ndjekja penale vepra penale të kryera sipas parashikimeve të këtij ligji. Përsa i përket përjashtimit nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose zëvendësimit të tij, organet kompetente janë ato të parashikuara nga ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e dënimeve penale" (i ndryshuar).

Kodi i Procedurës Penale në disa norma të tij parashikon efektet ligjore që sjell amnistia ndaj procedimit penal dhe ndjekjes penale. Kështu, sipas nenit 290/dh: "*Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur është dhënë amnisti*"; ndërsa neni 387/1 parashikon se: "*Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun*". Neni 428/1, shkronja "c" parashikon se: "*Gjykata e Apelit vendos*

prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin apo vazhdimin e procedimit"; ndërsa sipas nenit 442: "1. Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur: a) vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk duhet të fillonte e të vazhdonte. 2. Në rastet e parashikuara nga shkronja "a" Gjykata vendos pushimin e çështjes".

Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se amnistia e veprës penale gjen zbatim në të gjitha fazat procedurale të procesit penal, me pasojë pushimin e çështjes për ato vepra penale për të cilat ndjekja penale nuk duhet të fillojë ose të vazhdojë. Kështu, në rastet kur gjykata e shkallës së parë zbaton amnistinë e veprës penale, ajo ka detyrimin të deklarojë pushimin e çështjes. Nëse amnistia e veprës penale zbatohet në procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, këto të fundit duhet të prishin vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta dhe të pushojnë çështjen penale.

Nga ana tjetër, amnistia e dënimit gjen zbatim vetëm pasi vendimi penal bëhet i ekzekutueshëm sipas rregullave të parashikuara në nenet 417, 420/c dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale, duke e përjashtuar të gjykuarin, sipas rastit, nga vuajtja tërësisht ose pjesërisht e dënimit ose zëvendëson dënimin me një lloj dënimi më të butë.

7. Në çështjen në shqyrtim Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në zbatim të ligjit "Për dhënie amnistie", ka arsyetuar se i gjykuari quhet i dënuar (neni 4), se ai përfiton nga amnistia si rezultat i dënimit përfundimtar me 6 muaj burgim (neni 1) dhe se vepra penale për të cilën është dënuar nuk përfshihet në ato vepra për të cilat amnistia e dënimit nuk zbatohet (neni 3). Në interpretim të këtyre fakteve dhe të ligjit procedural penal, Kolegji Penal ka arritur në konkluzionin se gjykimi nuk mund të vazhdojë për shkak të efektit që sjell ligji për amnistinë në këtë çështje dhe, për pasojë, në zbatim neneve 387/1 dhe 442/1-a të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur "Pushimin e çështjes në Gjykatën e Lartë".

Gjykata vlerëson se Kolegji Penal ka zbatuar gabim nenin 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo normë zbatohet në rastin e amnistisë të veprës penale dhe jo në atë të amnistisë së dënimit me të cilën kanë të bëjnë faktet e pranuara në vendim. Edhe në rast se Kolegji Penal do të pranonte fakte që kishin të bënin me amnistinë e veprës penale, dhe si rrjedhim lejonin zbatimin e nenit 387/1 të Kodit të Procedurës Penale atëherë, në zbatim të neneve 441, germa "c", 442, pika 1, germa "a" dhe, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji duhej të vendoste prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e çështjes.

8. Zbatimi i normës jo në kontekstin e fakteve të pranuara ka kufizuar të drejtën e kërkuesit për gjykim pasi, në këtë rast, dhënia e vendimit të pushimit të çështjes nuk është në përputhje me detyrimin që ka Kolegji Penal për të dhënë një përgjigje përfundimtare lidhur me pretendimet e ngritura në rekurs. Kolegji Penal duhej të respektonte të gjitha standardet e procesit të rregullt në gjykimin e çështjes, pasi amnistia e dënimit nuk kufizon të drejtën e të gjykuarit për t'u gjykuar në përputhje me rregullat që parashikon Kodit të Procedurës Penale. për gjykimin në Gjykatën e Lartë. Pushimi i çështjes në Kolegjin Penal, pa u shprehur mbi vendimin e Gjykatës së Apelit, nuk ka sjellë asnjë pasojë mbi këtë vendim e për rrjedhojë, kërkuesi (i gjykuari) quhet ende i dënuar dhe i vetmi efekt i ardhur është përjashtimi nga vuajtja e dënimit. Gjykata thekson se interesi i të gjykuarit në një proces penal nuk është vetëm marrja e çfarëdo vendimi që e shmang atë nga vuajtja e një dënimi penal, por edhe zhvillimi i një gjykimi që i lejon atij mundësinë për të debatuar sipas parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, duke pasur si qëllim njohjen e pafajësisë për të rivendosur integritetin, nderin dhe reputacionin.

Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal duhej të kishte shqyrtuar në seancë gjyqësore pretendimet e kërkuesit, pra të zbatonte të drejtën mbi faktet e konstatuara e të vlerësuara në mënyrë të pavarur nga gjykata e apelit dhe të vendoste në përputhje me kompetencat e tij në një nga mënyrat e parashikuara në nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale.

9. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se zbatimi i gabuar i normave të Kodit të Procedurës Penale mbi kufijtë dhe rregullat e shqyrtimit gjyqësor dhe ato të marrjes së vendimit, ka sjellë mosgjykimin e thelbit të pretendimeve të kërkuesit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

duke i mohuar kështu shtetasit Gëzim Hysi të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, si element thelbësor i së drejtës për proces të rregullt ligjor.

III

Në lidhje me pretendimin se është cenuar e drejta e mbrojtjes e për rrjedhojë, barazia e armëve.

Kërkuesi ka pretenduar se duke e gjykuar çështjen në mungesë të mbrojtësit të të pandehurit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur nenet 31, 33 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nenin 6/1 të KEDNJ, të cilat garantojnë të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të garantimit të "barazisë së armëve".

Duke pasur parasysh argumentimin e mësipërm, sipas të cilit kërkuesit i është mohuar e drejta e aksesit për gjykim në Gjykatën e Lartë që përfshin mohimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizën e hollësishme të pretendimit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, pasi mohimi i të drejtës së aksesit në gjykim ka sjellë si pasojë pengimin e realizimit të së drejtës së mbrojtjes së kërkuesit, duke e lënë pa efekte këtë garanci mbrojtëse.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese, për shkak se kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "a" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.88, datë 21.02.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

-Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Admir Thanza, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar).